



Marketing

Ergen Kasemaj - 21/09/2005

Shërbime publiciteti për kompanitë e mirënjohura

CPR Production është një nga studiot në Shqipëri që ofron shërbimet e dizenjimit, markimit dhe hartimit të shtypit në fushën publicitare. Kjo kompani ka krijuar logon e organizatës "Mjaft!", Tirana International etj.

Kompanitë që ofrojnë shërbimet e tyre në fushën publicitare në Shqipëri janë shtuar shumë. Në një periudhë kohore prej 8 vjetësh, përveç se është shtuar konkurrenca në këtë fushë, ka ardhur dhe përparimi i këtyre firmave në ofrimin e shërbimeve të tyre. Tashmë edhe në Shqipëri, pa pasur nevojën e agjencive të huaja, organizatat dhe firmat e ndryshme shqiptare kanë mundësinë të krijojnë një logo ose markë, që do t'i ndihmojë në krijimin e një identiteti. Në këtë mënyrë këto firma publicitare kanë plotësuar boshllëkun që ekzistonte përpara disa vitesh në realizimin e publicitetit dhe në krijimin e identiteteve për markat. Shërbimet publicitare janë sektori i shërbimeve që po njih edhe rritjen më të madhe në Shqipëri, ndërmjet shërbimeve të tjera profesionale. Kjo rritje vjen nga vetë fakti që për organizatat dhe firmat është bërë shumë i rëndësishëm marketingu i tyre, më konkretisht, publiciteti. Ai mund të marrë format e medias së printuar ose mediave të tjera. Gjithashtu, i rëndësishëm për kompanitë është bërë edhe promovimi i shërbimeve apo produkteve, nëpërmjet mënyrave dhe materialeve të ndryshme të përdorura në promovim. Por vendin e parë në prioritet e tyre e mban krijimi i identitetit ose logos së një firme. Nëpërmjet krijimit të një logoeje një firmë bën prezantimin e saj para publikut, dhe në këtë drejtim ajo do të udhëheqë gjithë aktivitetin e saj për shumë vjet. Pra, është shumë e rëndësishme përgatitja dhe zgjedhja e një firme të specializuar që ofron ide dhe kreativitet për vendosjen e një logoeje. Një firmë që ofron këto shërbime për klientët e saj seriozë në Shqipëri është CPR Production.

Aktiviteti i firmës

Pjesa më e madhe e firmave që veprojnë në sferën publicitare është krijuar nga të rinj entuziastë, të cilët kanë punuar shumë me programet dizenjuese të kompjuterit. Disa nga këta të rinj kanë bërë edhe shkolla në vende të huaja në këtë profil, duke marrë eksperiencë. Në këtë mënyrë, ata i kanë hyrë sfidës për krijimin e agjencive të para shqiptare, që kanë konkurrentë në vend firma prestigjioze të huaja. CPR Production quhet firma që është krijuar nga një staf të rinjsh, e cila ka dizenuar logot për organizatat dhe kompanitë të mirënjohura që veprojnë në Shqipëri. Shërbimet e kësaj kompanie janë hartimi dhe dizenjimi i shtypit, si dhe dizenjimi i logove në procesin e markimit. Kjo firmë nuk ka shumë vjet që është krijuar, dhe ka arritur të krijojë klientelën e saj. Kjo, falë përpikmërisë dhe seriozitetit të tyre në punë. Misioni i kësaj kompanie është që strategjia e marketingut dhe dhënia e mesazhit të jepen në mënyrë po aq elegante sa edhe paraqitja vizuale.

Klientët

Shërbimet që ofrojnë për klientët përfshijnë një gamë të gjerë në fushën e komunikimit dhe marrëdhënieve me publikun. Kjo është një fushë e rëndësishme për organizatat e huaja që kontribuojnë me projektet e tyre në zhvillimin e vendit. Disa nga këto organizata kanë zgjedhur CPR Production për dizenjimin dhe hartimin e shtypit. Nga këto mund të përmendim ITAP, Komisioni Europian, Partners Albania, UNDP, OSCE, ambasada britanike dhe zyra e informimit të Këshillit të Europës. Gjithashtu, disa nga kompanitë dhe organizatat e mirënjohura që kanë zgjedhur CPR për të realizuar dizenjimin e shtypit të tyre, në kuadër të marrëdhënieve me publikun, janë edhe AMC, R&T Dataservice dhe Tirana International, Kryqi i Kuq Shqiptar dhe fondacioni "Abraham Linkoln". Një pjesë e klientëve të saj kanë zgjedhur shërbimet e krijimit të logos nga kjo firmë. Për shembull lëvizja "Mjaft!", Tirana International Hotel, Birra Arfi dhe Youth Link Leadership Institute për dizenjimin e logos dhe elementeve të tjera përbërëse janë asistuar nga CPR Production.

Konkurrenca

Janë të shumta kompanitë që veprojnë në fushën e publicitetit. Konkurrenca te këto kompani bazohet tek imazhi pozitiv i krijuar për to, më shumë se te larmia e shërbimeve që ofrojnë për klientët. Nga këto firma tashmë ofrohen të gjitha shërbimet e nevojshme në këtë fushë, si krijime posterash, katalogë reklamues, fletëpalosje e kartvizita prezantuese, stampime artistike, punime grafike e dekore, website e reklama në internet, ideim i fushatave publicitare, si dhe dizenjimi i logove. CPR Production është fokusuar te dizenjimi i logove dhe i shtypit për nevojat e kompanive dhe organizatave të ndryshme, gjë që i ka lejuar asaj të ketë sukses.

Shërbimet publicitare janë sektori i shërbimeve që po njih edhe rritjen më të madhe në Shqipëri, ndërmjet shërbimeve të tjera profesionale. Kjo rritje vjen nga vetë fakti që për organizatat dhe firmat është bërë shumë i rëndësishëm marketingu i tyre dhe, më konkretisht, publiciteti.

Boxx

Ndër konkurrentët që merren me këto aktivitete janë DDB Albania, Delta Publicity, Imazh, Dynamic Media, Iceberg Publicity, Quick, R&T Advertising, Fasada Studio, Artgraf, West Grafik, Pro Studio, Everest, Visi Design etj. Ky numër kaq i madh konkurrentësh mund të përballohet vetëm duke qenë i përpiktë, serioz dhe profesional në punët e krijuara. Vetëm duke qenë i tillë mund të dalësh mbi konkurrencën e ta fitosh klientelën besnike. CPR Production është fokusuar te dizenjimi i logove dhe i shtypit për nevojat e kompanive dhe organizatave të ndryshme, gjë që i ka lejuar asaj të ketë sukses.